2020 KOSINT
Kosovo Integration Initiative
Iniciativa e Kosovës për Përfshirje

ZBATIMI I MASAVE PËR PROMOVIMIN E PUNËSIMIT TË PJESËTARËVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI E EGJIPTIANNË VITIN 2019:

Raport vlerësimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 –2022

Artane Rizvanolli

|JANAR 2020

Zbatimi i masave për promovimin e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali e Egjiptiannë vitin 2019:

Raport vlerësimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 –2022

Artane Rizvanolli*

Janar 2020

Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit "Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020" të financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KO) në partneritet me Balkan Sunflowers (BSFK), Syri i Vizionit (SiV) dhe Roma and Ashkalia Documentation Center (RADC). Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

KOSINT falënderon përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, Zyrës për Qeverisje të Mirë (Zyra e Kryeministrit), dhe të organizatave të shoqërise civile, për informatat dhe kontributin e tyre për këtë raport.

Përmbajtja

1. Hyrje 4
2. Konteksti 6
3. Realizimi i masave dhe iaktiviteteve 10
3.1 Masa 1: Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës 10
3.1.1 Aktiviteti 3.1: Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të punësimit dhe I karakteristikave të punës për këto dy komunitete nga të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore 11
3.1.2 Aktiviteti 3.2: Raportimi i rregullt i të dhënave mbi përfitimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nga shërbimet dhe masat e ofruara nga APRK 11
3.2 Masa 2: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike 12
3.2.1 Aktiviteti 2.1: Monitorimi i situatës së punësimit në institucione publike në komunat me pjesëmarrje më të lartë të këtyre komuniteteve 13
3.2.2 Aktiviteti 2.2: Monitorimi i situatës së punësimit në institucione publike në nivel qendror 13
3.2.3 Aktiviteti 2.3: Informimi dhe avokimi, bazuar në rezultatet e hulumtimeve 14
3.2.4 Aktiviteti 2.4: Punësimi i këshilltarëve të punësimit nga këto komunitete komunat me numër më të madh të punëkërkuesve të këtyre komuniteteve 15
3.2.5 Aktiviteti 2.5: Trajnimi i këshilltarëve të punësimit të angazhuar 16
3.3 Masa 3: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali 16
3.3.1 Aktiviteti 3.1: Hulumtimi i masave të aksionit afirmativ që kanë funksionuar në vendet tjera 17
3.3.2 Aktiviteti 3.2: Zbatimi i kuotave në MATP (përfshirë trajnime profesionale) 17
3.4 Masa 4: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP 19
3.4.1 Aktiviteti 4.1: Hartimi i analizës së nevojave dhe efektivitetit të shërbimeve/MATP për këto dy komunitete 19
3.5 Masa 5: Dizajnimi/ modifikimi i shërbimeve të punësimit dhe masave aktive të punës në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali 21
3.5.1 Aktiviteti 5.1: Dizajnimi i MATP-ve/shërbimeve të punësimit në bazë të hulumtimit 21
3.5.2 Aktiviteti 5.2: Ofrimi i MATP-ve dhe granteve për fillim të biznesit 22
3.6 Masa 6: Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës 23
3.6.1 Aktiviteti 6.1: Organizimi i fushatës së informimit me pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali 23

3.7 Masa 7: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali 25
3.7.1 Aktiviteti 7.1: Emetimi i videove promovuese 25
3.7.2 Aktiviteti 7.2: Takime me qytetarët 25
4. Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit 26
4.1 Indikatori 1: Norma e punësimit 26
4.2 Indikatori 2: Norma e punësimit të grave 27
4.3 Indikatori 3: Përfshirja në MATP 28
4.4 Indikatori 4: Përfshirja e grave në MATP 29
4.5 Indikatori 5: Përfshirja në punësim në sektorin publik 30
5. Konkludimet dhe rekomandimet 36

1. Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i nivelit të arritjes së rezultateve dhe i zbatimit të aktiviteteve dhe i masave të parapara në Strategjinë Sektoriale tëMinistrisë sëPunës dhe Mirëqenies Sociale 2018 –2022, në lidhje me promovimin e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë gjatë vitit 2019.Raporti synon të përbëjë vazhdimësi të monitorimit të kësaj Strategjie të realizuar në vitin paraprak. Rrjedhimisht, ai ndjek formatin dhe metodologjinë e raportit tëmonitorimit të realizuar për vitin 2018 por edhe e pasuron më tejmonitorimin, duke i zgjeruar burimet e të dhënave të cilat në këtë vit përfshijnë edhe intervista me Zyrat e Punësimit në komunat ku ka pjesëmarrje më të lartë të këtyre komuniteteve, si dhe njëanketë me pjesëtarë të këtyre komuniteteve.

Për qëllimetë këtij raporti, janë analizuar dokumentet strategjike, analizat, raportet vjetore dhe të dhënat e institucioneve relevante për vitet e fundit, me përqëndrim të veçantë në ato të vitit 2019, si dhe janë mbledhur të dhënat primare si në vijim.

1. Janë realizuar ***intervista gjysmë të strukturuara*** me përfaqësuesit e institucioneve relevante:
   - ✓ Departamenti për Punë dhe Punësim, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
   - ✓ Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, si dhe njësitë në nivel komunal të kësaj agjencie:
     - Zyra e Punësimit në Ferizaj
     - Zyra e Punësimit në Fushë Kosovë
     - Zyra e Punësimit në Gjakovë
     - Zyra e Punësimit në Mitrovicë
     - Zyra e Punësimit në Pejë
   - ✓ Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Qeverinë e Kosovës
2. Duke qenë se një pjesë e masave dhe aktiviteteve në Strategjinë Sektoriale të MPMS janë paraparë të realizohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ose nga vetë këto organizata, dhe me qëllim të marrjes së informatave më të plota nga terreni, për qëllim të këtij raporti është organizuar edhe një***intervistë grupore gjysmë e strukturuar me përfaqësues të projekteve ose organiztave joqeveritare (OJQ) që merren me çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian*** në Kosovë:
   - ✓ Balkan Sunflowers
   - ✓ Bashkimi Rinor e Ardhmja e Ndritur (BRAN)

- ✓ Nevo Koncept
- ✓ Përparimi Rinor i Ashkalive të Mitrovicës (PRAM)
- ✓ Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkalike dhe Egjiptiane (RROGRAE)
- ✓ Syri i Vizionit (SiV)
- ✓ Qendra Kosovare për Arsim (KOSINT)
- ✓ Roma and Ashkalia Documentation Center (RADC)
- ✓ Roma Versitas Kosovo
- ✓ Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE)

3. Duke pasur parasysh që një pjesë e masave dhe e aktiviteteve të Strategjisë kanë për qëllim nivelin e informimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian dhe ngritjen e nivelit tëpërfitimit të tyre nga shërbimet e punësimit dhe pjesëmarrjen nëmasataktive të tregut të punës, për qëllim të raportit është**realizuar edhe një*anketë me 139 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në moshë pune*** në pesë
4. komuna me prani më të lartë të këtyre komuniteteve: Ferizaj, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Pejë dhe Gjakovë.

Bazuar në burimet më lartë, raporti përmbledhë arritjet e vitit 2019 në fushën e promovimit të punësimit të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në Kosovë, me përqendrim të veçantë tek aktivitetet, masat dhe rezultatetet e parapara me Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022, e cila për këtë fushë i referohet Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021.

Raporti është i organizuar si vijon. Seksioni 2 paraqet kontekstin e kësaj analize dhe i përmbledhë dokumentet strategjike relevante në këtë fushë. Seksioni 3 paraqet masat, aktivitetet dhe rezultatet e parapara me Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022 (dhe Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021) dhe nivelin e përmbushjes së tyre gjatë vitit 2018.Seksioni 4 i përmbledhë gjetjet, dhe ofron disa rekomandime për zbatimin e kësaj fushe të strategjisë gjatë viteve në vijim.

2. Konteksti

Megjithëse të dhënat zyrtare për treguesit e tregut të punës të disagreguara në nivel të komuniteteve mungojnë në Kosovë, analizat e ndryshme tregojnë se gjendja e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është shumë e rëndë, siç përmblidhet edhe në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021. Këto komunitete kanë normë më të lartë të papunësisë dhe normë më të ulët të punësimit në krahasim me shumicën shqiptare si dhe me komunitetet tjera pakicë në Kosovë.Për shembull, Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2010 vlerëson se shkalla e papunësisë tek këto komunitete në vitin 2009 ishte rreth 58 për qind, në krahasim me mesataren e popullatës prej 45 për qind[1].Ndërsa, disa vite më vonë vlerësohet se në komunat e Obiliqit dhe Fushë Kosovës shkalla e punësimit për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët ishte vetëm 7 për qind, krahasuar me 40 për qind për shqiptarët dhe 21 për qind për serbët[2]. Për më tepër, vendet e punës në të cilat janë të angazhuara këto komunitete janë shpesh të përkohshme dhe përbëjnë punë fizike që nuk kërkojnë shkathtësi të larta dhe nuk paguhen mirë[3], ndërsa këto komunitete janë të nën-përfaqësuara edhe në punësimin në institucione publike dhe në ndërmarrjet publike[4], megjithëse ekziston një kornizë ligjore që siguron përfshirjen e tyre në punësim në sektorin publik.

Rëndësisë së veçantë për integrimin e këtyre komuniteteve (bashkë me arsimin, banimin, mirëqenien sociale dhe shëndetësinë) në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 të aprovuar nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2017. Duhet theksuar se kjo Strategji fillimisht ishte dedikuar për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, mirëpo Qeveria e Kosovës e ka hequr komunitetin egjiptian nga masat e parapara në Strategji në fazën përfundimtare të aprovimit të saj, pasi ishte hartuar drafti përfundimtar i këtij dokumenti strategjik në një proces gjithëpërfshirës gjatë të cilit kanë bashkëpunuarZyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në Qeverinë e Kosovës, ministritë përkatëse dhe organizata të shumta të shoqërisë civile në Kosovë të cilat merren me çështjet e këtyre komuniteteve.

[1]Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2010.

[2]Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Community Vulnerability Assessment Report, 2013.

[3] Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Gjendja e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, 2010, dhe Organizata Botërore e Punës (ILO), Tranzicioni i të Rinjve në Punë të Mirë: Dëshmitë nga Kosova, Dokumenti i Politikave të Punësimit i ILO 2007/4.

[4] Sh.Berisha për Institutin Demokratik i Kosovës (KDI), Hulumtim Parlamentar: Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në shërbim civil, 2016, dhe Zyra e Kryeministrit/Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim i Punësimit të Pjesëtarëve të Komuniteteve jo-shumicë në Shërbimin Civil dhe Ndërmarrjet Publike në Kosovë, 2013.
Dh. Prokshi për KOSINT 2020, Respektimi i kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në institucione publike, 2019

Megjithëse Strategjia në versionin përfundimtar të aprovuar nga Qeveria e Kosovës i referohet vetëm komuniteteve rom dhe ashkali, është inkurajuese që përkundër këtij fakti institucionet kosovare kanë vazhduar të punojnë për integrimin e këtyre tri komuniteteve pa dallim, duke e pasur parasysh se pavarësisht dallimeve eventuale në mes tyre, të tri këto komunitete përballen me sfida të njëjta në fushën e punësimit. Përfshirja e këtij komuniteti në aktivitetet e rregullta (si forume, takime të përbashkëta, etj.) si dhe në aktivitete specifike për tësiguruar integrimin e tyre ka vazhduar gjatë gjithëkohës, sic konfirmohet nga ZQM. Ngjashëm, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)në Strategjinë Sektoriale 2018 – 2022 të saj, si dhe në Politikën e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021 i referohet të tri këtyre komuniteteve në objektivat dhe aktivitetet e parapara për promovimin e punësimit në Kosovë.

Për fushëne punësimit Strategjia Sektoriale e MPMS 2018 – 2022 përcakton Objektivin strategjik 1, dhe pesë Objektiva specifike që detajojnë më tej këtë objektiv, njëri prej të cilëve është përmirësimi i niveli i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (shih Kutinë2.1).

Objektivi strategjik 1: Ulja e inaktivitetit, rritja e punësimit, zhvillimi i shkathtësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe administrimi më i mire i tregut të punës.

Objektivi specifik 1.1: Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve publike të punësimit

Objektivi specifik 1.2: Zgjerimi i shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve, si dhe ngritja e efiçiencës dhe cilësisë së tyre

Objektivi specifik 1.3: Ofrimi i shërbimeve cilësore të aftësimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës

Objektivi specifik 1.4: Rritja e punësimit të të rinjve

Objektivi specifik 1.5: Përmirësimi i nivelit të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (aktivitetet e planifikuara në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian* në Shoqërinë Kosovare 2017-2021)

_____

*Vini re që Strategjia Sektoriale e MPMS në kohën e hartimit të saj i referohet dokumentit të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, para se komuniteti egjiptian të hiqet nga teksti në fazën përfundimtare

Kutia 2.1: Objektivat e Strategjisë Sektoriale të MPMS 2018 – 2022

Burimi: Strategjia Sektoriale e MPMS 2018 – 2022

Për Objektivin specifik 1.5 që i referohet nivelit të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, Strategjia Sektoriale e MPMS 2018 – 2022 nuk parasheh aktivitete specifike shtesë, mirëpo i referohet Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021. Duke pasur parasysh mudësitë reale të politikëbërësve për të ndikuar nënivelin e punësimit të këtyre komuniteteve në kushtet e një ekonomie tregu, si dhe kornizën ligjore në fuqi, kjo e fundit parasheh masa dhe aktivitete që në vija të trasha mund të përmbidhen si vijon:

- ✓ Nxitjen e zbatimit të kornizës ligjore që rregullon e përfaqësimit në punësim të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil në favor të punësimit të këtyre komuniteteve.
- ✓ Nxitjen e punësimit të këtyre komuniteteve në sektorin publik dhe privat përmes masave aktive të tregut të punës të realizuara nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK)[5], përfshirë masat që nxisin punëdhënësit për të punësuar pjesëtarë të këtyre komuniteteve (si p.sh. subvencionimi i pagave) dhe ato që ngrisin shkathtësitë e punëkërkuesve të këtyre komuniteteve për t'i përgatitur ato për vendet e punës në përputhje me nevojat e tregut (si p.sh. aftësimi profesional). Në kuadër të këtyre aktiviteteve përfshihet edhe informimi i këtyre komuniteteve për mundësitë që APRK ofron për të papunët, si parakusht që do të mundësonte përmirësimin e qasjes së tyre tek shërbimet dhe masat në dispozicion.

Një sfidë serioze për realizimin aktiviteteve të parapara përbën fakti që për Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021, të cilës i referohet Strategjia Sektoriale e MPMS 2018 – 2022, Qeveria e Kosovës nuk ka linjë specifike të buxhetit. Në vend të kësaj, parashihet qëministritëdhe sektorëttëzbatojnë aktivitete tëStrategjisë në kuadër të buxheteve të tyre ekzistuese (me ndihmën e donatorëve dhe OJQ-ve në disa raste). Si rrjedhojë e kësaj ka vështirësi në zbatimin e disa aktiviteteve, por edhe është e pamundur që të monitorohet realizimi i buxhetit të shpenzuar për aktivitetet që janë realizuar për shkak të mungesës së të dhënave buxhetore të disagreguara.

Seksioni në vijim ofron një pasqyrë më të detajuar të masave dhe aktiviteteve të parapara në këto dokumente strategjike, si dhe nivelin e zbatimit të tyre dhe përparimin në arritjen e rezultateve të parapara (aty ku të dhënat lejojnë) përgjatë viteve 2017 – 2019.

[5] Vini re që Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 i referohet këtyre si "masa të realizuara nga MPMS", meqë kjo ka qenë praktika deri në themelimin dhe funksionalizimin e APRK e cila tani është përgjegjëse për zbatimin e masave aktive të tregut të punës, përderisa MPMS e ka rolin e politikëbërjes në fushën e promovimit të punësimit.

Duke qenë se për Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021, aktivitetet e së cilës janë bartur në Strategjinë Sektoriale të MPMS 2018 – 2022, ekziston një Kornizë për vlerësim e përkrahur nga projekti i financuar nga Bashkimi Evropian "Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN"[6], dhe kjo kornizëështë marrë parasysh përgjatë realizimit të këtij vlerësimi. Gjithashtu, duhet theksuar se përkundër faktit që Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 i referohet vetëm komuniteteve rom dhe ashkali, gjatë këtij vlerësimi do të raportohen statistikat dhe aktivitetet për të tri komunitetet (rom, ashkali dhe egjiptian) për dy arsye: (i) për të reflektuar në mënyrë më të plotë aktivitetet e institucioneve, të cilat, siç u shpjegua më lartë, vazhdojnë të angazhohen për përmirësimin e gjendjes së të tri këtyre komuniteteve dhe, (ii) për arsyen praktike dhe teknike që në kohën e hartimit të Strategjisë statistikat për vitin bazë (p.sh. pjesëmarrja e këtyre komuniteteve në masa aktive të tregut të punës) janë përllogaritur duke pasur parasysh të tri komunitetet, prandaj çdo ndryshim metodologjik në këtë fazë do t'a bënte të pakuptimtë krahasimin në mes shifrave aktuale dhe atyre bazë.

Së fundmi, duhet cekur se ky raport monitorimi ka disa mangësi në monitorim të indikatorëve për matjen e arritjes së objektivit dhe

[6]Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN), Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021: Korniza e monitorimit, 2017.

3. Realizimi i masave dhe iaktiviteteve

Strategjia parasheh 7 masa, me aktivitetet e tyre përkatëse, për arritjen e përmirësimit tësituatës ekonomike të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian përmes përmirësimit të punësimit të këtyre komuniteteve. Nënseksionet në vijim shpjegojnë përmbajtjen e tyre sic janë paraparë në Strategji dhe nivelin e realizimit të secilit aktivitet gjatë vitit 2019 dhe, aty ku është relevante, edhe gjatë viteve paraprake.

3.1 Masa 1: Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës

Masa e parëe paraparë në Strategji në fushën e punësimit është "hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe mbi përfitimin e tyre nga shërbimet/masat e ofruara nga MPMS[7]". Kjo masë parashihet të zgjasë përgjatë periudhës së Strategjisë: 2017-2019.

Në kuadër tëkësaj mase parashihet analizimi i mundësive për shfrytëzimin e të dhënave ekzistuese, me përqëndrim të veçantë në burimet periodike të të dhënave si Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) dhe Sistemi i Informatave të Tregut të Punës (SIMP) i APRK, që do të mundësonin monitorimin e gjendjes së tregut të punës të këtyre komuniteteve. Informatat që do të duhej të përfshijnë janë: nivelin/shkallën e punësimit të këtyre komuniteteve në përgjithësi dhe sipas sektorëve/karakteristikave të punës (punë e rregullt ose e përkohshme, punë formale ose joformale, aktiviteti ekonomik, sektori publik/privat); dhe treguesit tjerë bazikë të tregut të punës (shkalla e papunësisë, shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës).

Megjithëse realizimi i kësaj mase nuk do të kishte ndikim direkt në kuptim të rritjes së punësimit të këtyre komuniteteve, ky do të mundësonte: monitorimin e situatës; transparencë mbi nivelin e përkrahjes institucionale për promovim të punësimit përmes institucionit të mandatuar për këtë qëllim nga Qeveria e Kosovës, APRK-së; avokim për përmirësim të mëtejme të situatës.

[7] Vini re që në kontekstin e ri institucional, kjo masë duhet t'i referohet masave të ofruara nga APRK.

3.1.1 Aktiviteti 3.1: Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të punësimit dhe I karakteristikave të punës për këto dy komunitete nga të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore

Gjatë hulumtimit nuk është gjetur ndonje statistikë ose raport që dëshmon se ky aktivitet është realizuar. Gjithashtu, në bazë të intervistave me institucionet dhe OJQ-të që merren me çështje të

> Sikurse gjatë viteve paraprake të monitorimit të kësaj strategjie, as në vitin 2019 nuk janë përllogaritur treguesit e ndjeshëm gjinor në lidhje me punësimin e komuniteteve Rom, Ashkali e Egjiptian në bazë të burimeve zyrtare dhe të rregullta të të dhënave sicështë Anketa e Fuqisë Punëtore.Në këtë mënyrë, mbetet status-quo e pamundësisë për të monitoruar gjendjen e punësimit të këtyre komuniteteve, që do të mundësonte edhe avokim më të fuqishëm në bazë të rezultateve.

komuniteteve rom, ashkali e egjiptian nuk është identifikuar ndonjë hap konkret për ta realizuar këtë aktivitet.Gjatë vitit 2018 ishin publikuar disa raporte nga organizata ndërkombëtare dhe lokale në lidhje me punësimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, megjithësekëto analiza nuk ofronintë dhëna në nivel vendi dhe statistika standarde të tregut të punës si shkalla e punësimit, shkalla e papunësisë, etj.[8]Ndërsa gjatë vitit 2019 nuk ka pasur as raporte të tilla.

3.1.2 Aktiviteti 3.2: Raportimi i rregullt i të dhënave mbi përfitimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nga shërbimet dhe masat e ofruara nga APRK

Gjithashtu në kuadër të Masës 1 parashihet që statistikat e rregullta që mblidhen me anë të SIMP të APRK-së, si numri dhe përqindja e punëkërkuesve të regjistruar, punëkërkuesve për të cilët është ndërmjetësuar punësimi, pjesëmarrësve në trajnime profesionale dhe masa tjera aktive të tregut të punës, tëraportohen veç e veç për secilin nga këto komunitete. Ky aktivitet është realizuar për herë të parë në vitin 2018 dhe kjo praktikë ka vazhduar edhe në vitin 2019 siç dëshmohet nga raporti vjetor Puna dhe punësimi i APRK-së për vitin 2018[9] i cili iraporton të gjitha statistikat nga SIMP për të tri komunitete veç e veç[10].

[8] A. Rizvanolli për KOSINT 2020 Zbatimi i masave për promovimin e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali e Egjiptian në vitin 2018: Raport vlerësimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 –2022, 2019.
[9]Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), Puna dhe punësimi: Raport vjetor 2018.
[10] Raporti vjetor për vitet 2017 dhe 2018 nuk është publik, mirëpo ai është siguruar nga APRK për qëllim të këtij hulumtimi.

Sikurse gjatë dy viteve paraprake (2017 dhe 2018), në vitin 2019 APRK ka raportuar në raportin e saj vjetor "Puna dhe Punësimi" treguesit e ndjeshëm gjinor për komunitetetrom, ashkali e egjiptian ve [e ve [. Sipas këtij klasifikimi janë raportuar të gjithë indikatorët që raporton APRK, duke përfshirë numrin dhe përqindjen e punëkërkuesve të regjistruar, punëkërkuesve për të cilët është ndërmjetësuar punësimi, pjesëmarrësve në trajnime profesionale dhe masa tjera aktive të tregut të punës, etj. Megjithëse ky rezultat nuk ka ndikim direkt në punësim, ky shënon përparim signifikant sepse tani mund të monitorohet mbështetja institucionale për promovimin e punësimit të këtyre komunitetve të ofruar nga APRK si institucion i mandatuar përë këtë cështje, gjë që mundëson vetëdijësim dhe avokim më të fuqishëm.

3.2 Masa 2: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike

Që nga viti 2010, Ligji 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcakton përfaqësimin në shërbimin civil për komunitetet jo shumice përmes kuotës minimale prej 10 për qind në nivel qendror dhe përfaqësimit proporcional me përbërjen demografike në nivel komunal. Kjo masë parasheh angazhimin e këshilltarëve të punësimit nga rradhët e këtyre komuniteteve dhe monitorim e raportim të rregullt mbi zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese, me fokus të veçantë në përfaqësimin, në përputhje me përbërjen e popullatës në nivel komunal por edhe në atë qendror, megjithëse nuk ka kuota specifike për komunitetet veç e veç. Në rast të ngecjeve në zbatim të kornizës ligjore, duhenhulumtuar shkaqet dhe duhet marrë masa sipas nevojës. Duke pasur parasysh natyrën e këtyre aktiviteteve të monitorimit, ishte paraparë që këto aktivitete të zhvillohen nga OJQ-të, me mbështetje tëdonatorëve. Përvec kësaj, parashihej që APRK të punësojë këshilltarë punësimi.

Megjithëse realizimi i kësaj mase nuk do të kishte ndikim direkt në kuptim të rritjes së punësimit të këtyre komuniteteve, ky do të mundësonte përparim domethënës duke mundësuar: informim, vetëdijësim dhe avokim për punësimin në sektorinpublic, qëështë fusha ku institucionet mund të kenë ndikim direkt dhe relativisht të shpejtë në punësim të një numri të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, si dhe qasje më të mirë dhe besim të përforcuar të qytetarëve të këtyre komuniteteve tek APRK.

3.2.1 Aktiviteti 2.1: Monitorimi i situatës së punësimit në institucione publike në komunat me pjesëmarrje më të lartë të këtyre komuniteteve

Gjatë dy viteve të para të Strategjisë nuk kishte pasur hulumtime të reja për këtë çështje që nga aprovimi i saj (e fundit ishte analiza e KDI në vitin 2016[11]) apo aktivitete (tryeza, etj.) që synojnë vetëdijësimin e institucioneve dhe publikut dhe avokimin për përfshirje më të madhe të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në punësim në sektorin publik në nivel komunal.

Gjatë vitit 2019 është bërë përparim i dukshëm në këtë aktivitet me publikimin e raportit të zbatuar nga Projekti KOSINT i cili ka paraqitur të dhënat mbi gjendjen e punësimit të komuniteteve rom,

> Për dallim prej dy viteve paraprake (2017 dhe 2018), në vitin 2019 nga projekti KOSINT është realizuar hulumtimi mbi punësimin e pjesëtarëve komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik. Në nivel lokal, raporti përfshin periudhën 2016-2018 në komunat: Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjakovë dhe Mitrovicë. Publikimi i raportit shënon përparim, megjithëse rezultatet e tij nuk janë direkte në punësim.

ashkali dhe egjiptian në sektorin publik në nivel lokal, që përfshin administratën publike, sektorin e shëndetësisë dhe sektorin e arsimit. Raporti mbulon punësimin në vitet 2016-2018 në komunat: Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjakovë dhe Mitrovicë. Të dhënat e këtij raporti në lidhje me këtë aktivitet paraqiten nëSeksionin 4 që diskuton arritjen e rezultateve të parapara me Strategji.

3.2.2 Aktiviteti 2.2: Monitorimi i situatës së punësimit në institucione publike në nivel qendror

Ngjashëm ne Aktivitetin 2.1, edhe Aktiviteti 2.2 parasheh monitorimine situatës së punësimit në institucione publike, por në nivel qendror.As për këtë cështje nuk kishte pasur hulumtime të reja që nga aprovimi i Strategjisë, apo aktivitete (tryeza, etj.) që synojnë vetëdijësimin e institucioneve dhe publikut dhe avokimin për përfshirje më të madhe të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në punësim në sektorin publik në nivel qendror.

Edhe në këtë aktivitet përparim i dukshëm në vitin 2018 është bërë me publikimin e raportit të zbatuar nga Projekti KOSINT i cili ka paraqitur të dhënat mbi gjendjen e punësimit të komuniteteve

[11] Sh. Berisha për Institutin Demokratik i Kosovës (KDI), Hulumtim Parlamentar: Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në shërbim civil, 2016.

rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik dhenë nivelin qendror. Raporti mbulon punësimin në institucionet publike në nivel qendror (qeverinë dhe agjencitë e pavarura) në vitet 2016-2018.

Mangësi e këtij raporti është që nuk raportohen të dhënat për punësimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në ndërmarrjet publike, por megjithatë të dhënat e raportuara paraqesin në masë të madhe gjendjen e punësimit në sektorin publik.Edhe sa i përket këtij aktiviteti, të dhënat e këtij raporti paraqiten në Seksionin 4 që diskuton arritjen e rezultateve të parapara me Strategji.

Për dallim prej dy viteve paraprake (2017 dhe 2018), në vitin 2019 nga Projekti KOSITNT është realizuar hulumtim mbi punësimin e pjesëtarëve komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik. Në nivel qendror, raporti përfshin periudhën 2017-2018 në qeveri dhe agjenci të pavarura publike, por jo për ndërmarrjet publike. Publikimi i raportit shënon përparim, megjithëse rezultet e tij nuk janë direkte në punësim.

3.2.3 Aktiviteti 2.3: Informimi dhe avokimi, bazuar në rezultatet e hulumtimeve

Masa 2 gjithashtu parasheh që analizat e përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në punësim në sektorin publik të shfrytëzohen nga OJQ-të për qëllim të informimit dhe avokimit tek institucionet relevante për këtë cështje. Duke qenë se gjatë viteve të kaluara nuk kishte pasur analiza të tilla, ky aktivitet nënkuptohet që nuk mund të realizohej. Ndërsa me publikimin e raportit të Projektit KOSINT në Nëntor të vitit 2019 është arritur përparim në këtë aktivitet. Raporti është prezantuarnë një ngjarje ku morën pjesë përfaqësuesit e ZQM, MPMS, APRK dhe të institucioneve e organizatave të tjera relevante[12].Gjatë vitit vijues rezultatet e këtij raporti mund të përdoren për aktivitete të mëtejme avokimi, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik.

[12]Në këtë prezantim ishin të ftuar përfaqësuesit e ZQM, MPMS, APRK dhe institucioneve të tjera relevante.

Në vitin 2019 është realizuar përparim në këtë aktivitet me rastin e prezantimit të analizës së realizuar nga Projekti KOSINT mbi punësimin e pjesëtarëve komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik (në nivel qendror dhe lokal). Prezantimi i raportit në Nëntor të vitit 2019 mund të konsiderohet si realizim i pjesshëm i këtij aktiviteti, dhe efekti i masës me gjasë ka qenë i kufizuar. Mirëpo rezultatet e këtij hulumtimi mund të përdoren gjatë vitit vijues për aktivitete të mëtejme informimi dhe avokimi në nivel qendror dhe lokal për të arritur potencialin e saj të plotë.

3.2.4 Aktiviteti 2.4: Punësimi i këshilltarëve të punësimit nga këto komunitete komunat me numër më të madh të punëkërkuesve të këtyre komuniteteve

Masa 2 gjithashtu parasheh targetim specifik të këtyre komuniteteve në angazhimin si këshilltarë të punësimit (të pasuar nga trajnimi i këtyre këshilltarëve), gjë që do të ndihmonte në forcimin e qasjes së institucioneve ndaj këtyre komuniteteve dhe forcimin e besimit të këtyre ndaj institucioneve.Kjo nuk është realizuar as gjatë vitit 2019. Për më tepër, APRK ka shprehur qëndrimin se targetimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nuk mund të realizohet për shkak se në konkurse publike procedurat e rekrutimit janë të rregulluara me ligj dhe nuk lejojnë kushte të tilla në konkurs. Rrjedhimisht, sugjerohet qëky aktivitet të rishikohet nga ana e ZQM me ndihmën e ekspertëve juridikë dhe APRK-sëqë të shihet nëse ky aktivitetet duhet të rishikohet ose të hiqet fare nga Strategjia.

Sikurse në dy vitet paraprake, as në vitin 2019 nuk është realizuar përparim në këtë aktivitet, duke ruajtuar kështu status quo-në. Duke qenë se janë ngritur dyshime nësenjë formë e tillë e rekrutimit në baza etnike është fare e mundshme brenda kornizës ligjore në fuqi,sugjerohet që ky aktivitet të rishikohet nga ana e ZQM me ndihmën e ekspertëve juridikë dhe APRK-së që të vlerësohet nëse ky aktivitetet duhet të revidohet ose të hiqet fare nga Strategjia.

3.2.5 Aktiviteti 2.5: Trajnimi i këshilltarëve të punësimit të angazhuar

Duke qenë se Aktiviteti 2.5 pason Aktivitetin 2.4 i cili nuk është realizuar (dhe, sic diskutohet më lart, duket se nuk është i realizueshëm në formëtë të tillë), sugjerohet që ky aktivitet të rishikohet së bashku më aktivitetin 2.5

> Ky aktivitet pason Aktivitetin paraprak 2.4, prandaj nënkuptohet që nuk ka mundur të realizohet. Sugjerohet që ky aktivitet të rishikohet së bashku me aktivitetin paraprak.

3.3 Masa 3: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali

Masa 3 parasheh analizë të masave afirmative potenciale (përfshirë praktikat ndërkombëtare në këtë fushë) që do të mund të përdoreshin për punësimin e komuniteteve rom, dhe ashkali për bizneset dhe organizatat jofitimprurëse. Hulumtimi do të fokusohej veçanërisht në realizueshmërinë e tyre dhe realizimin në mënyrë të drejtë (p.sh. definimi i masës; kriteret për përfitim; procedurat e vlerësimit të kritereve, përfshirë verifikimin e etnisë së të punësuarit). Përvec kësaj, parashihet që kuotat si masë e aksionit afirmativ të përdoren për skemat e masave aktive të tregut të punës.

Aktivitetet e kësaj mase, në mënyrë direkte ose indirekte do të mund të kishin ndikim domethënës në përmirësimin e gjendjes së punësimit të këtyre komuniteteve.

3.3.1 Aktiviteti 3.1: Hulumtimi i masave të aksionit afirmativ që kanë funksionuar në vendet tjera

Megjithëse gjatë vitit 2018 kishte pasur një raport që ndër të tjera ka analizuar praktikat ndërkombëtare për promovimin e punësimit të komunitetit rom në vendet tjera të Evropës nga

Gjatë vitit 2019 nuk është arritur përparim në këtë drejtim, megjithëse gjatë vitit 2018 kishte pasur një raport që ndër të tjera ka analizuar praktikat ndërkombëtare për promovimin e punësimit të komunitetit rom në vendet tjera të Evropës nga Qendra Projekti KOSINT, i cili kontribuonte pjesërisht në realizimin e kësaj mase.Në mungesë të një hulumtimi specific për këtë cështje dhe konsiderimit/adoptimit të rekomandimeve të tij, nuk mund të thuhet se ka pasur ndonjë efekt.

Projekti KOSINT, i cili kontribuonte pjesërisht në realizimin e kësaj mase, ky aktivitet siç ka qenë e paraparë kishte mbetur i parealizuar[13]. As gjatë vitit 2019 nuk është realizuar ndonjë hulumtim i masave të aksionit afirmativ që kanë funksionuar në vendet tjera.

3.3.2 Aktiviteti 3.2: Zbatimi i kuotave në MATP (përfshirë trajnime profesionale)

Masa gjithashtu parasheh që kuotat si masë e aksionit afirmativ të përdoren për skemat e masave aktive të tregut të punës dhe për trajnimet profesionale, dhe që këto të përcaktohen për këto komunitete në mënyrë specifike.Sikurse është shpjeguar në raportin e monitorimit të Strategjisë për vitin e kaluar[14], MPMS gjatë vitit 2018 ka zgjedhur qënë vend të kuotave fikse, tëtrajtojëçështjen e punësimit të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në dokumentin kryesor politikëbërës në fushën e provomimit të punësimit nga MPMS, Politikën e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021. Megjithëse nuk parasheh kuota për skemat specifike, ky dokument reflekton aktivitetet e parapara me Strategji për promovimin e punësimit të këtyre komuniteteve dhe përcakton caqe për APRK-në për përfshirje të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në masa aktive të tregut të punës, pëfshirë në aftësim profesional të ofruar në Qendrat për Aftësim Profesional. Caqet e vendosura janë paraqitur në Tabelën 3.1[15].

[13] Shih A. Rizvanolli për Projektin KOSINT, Zbatimi i masave për promovimin e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali e Egjiptian në vitin 2018: Raport vlerësimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 –2022, 2019.
[14] Shih A. Rizvanolli për Projektin KOSINT, Zbatimi i masave për promovimin e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali e Egjiptian në vitin 2018: Raport vlerësimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 –2022, 2019.
[15] Si më lart.

Tabela 3.1: Caqet për përfshirje të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian

Treguesi	Situata fillestare	Caqet		
	2017	2019	2020	2021
% e personave nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian përfitues të masave aktive të tregut të punës	3%	4%	5%	6%
% e personave nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian që ndërmjetësohen në punësim	3.4%	4%	5%	6%

Burimi: MPMS, Politika e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021

Gjatë vitit 2019, deri në kohën e përpilimit të këtij raporti nuk ka pasur zhvillime të reja në këtë aspekt. Në këtë kohë, Politika e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021është në fazën e vlerësimit të arritjes së rezultateve nga APRK, që mund të pasojë me rishikimin e saj në bazë të rezultateve të arritura deri tani, mirëpo në këtë fazë mund të vlerësohet vetëm dokumenti origjinali aprovuar në vitin 2018. Sicështë shpjeguar në raportin e vitit të kaluar, megjithëse Politika e Punësimit parasheh dyfishim të pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, duhet theksuar se baza (situata fillestare) për vitin 2017 që përdoret në këtë dokument është shumë më e ulët sesa ajo e vitit paraprak (6 për qind) që përdoret në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021, së cilës i referohet Strategjia Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022. Rrjedhimisht, edhe caku për vitin 2021 prej 6 për qindësh të shumë më i ulët sesa ai prej 10 për qind i vendosur me Strategji për të njëjtin vit.

Nga ana tjetër, sic diskutohet në Seksionin 4.3, duket se ka vështirësi në arritjen madje edhe të cakut të vënë në Politikën e Punësimit.

Megjithëse nuk janë realizuar kuotat, janë vënë caqet për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në masa aktive të tregut të punës. Duke qenë se caqet janë vendosur më ulët sesa ato që kanë qenë të parapara me Strategji, efekti i tyre me gjasë është i kufizuar. Mirëpo, efekti nuk mund të matet për arsye të mungesës së të dhënave mbi efektivitetin e masave aktive të tregut të punës në punësim.

3.4 Masa 4: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP

Masa 4 ka një aktivitet, i cili parasheh vlerësimin e nevojave dhe të sfidave specifike të komuniteteve rom dhe ashkali, dhe vlerësimin e efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP (përfshirë trajnimin profesional) të realizuara në të kaluarën; këto do të përbënin bazën e dizajnimit ose modifikimit të shërbimeve dhe MATP në përputhje me nevojat specifike të këtyre komuniteteve. Analiza do të përfshinte perceptimet e këtyre komuniteteve dhe vlerësimin e tyre për qasjen dhe efektivitetin e këtyre shërbimeve/masave, si dhe matës objektivë të efektivitetit të tyre siç janë statusi i punësimit i përfituesve dhe qëndrueshmëria e punësimit.

Realizimi i kësaj mase do tëmund të kishte efekt domethënës në punësimin e këtyre komuniteteve, duke qenë se do të mundësonte përmirësim e cilësisë dhe përshtatshmërisë se shërbimeve dhe masave aktive të tregut të punës me kërkesat e punëkërkuesve.

3.4.1 Aktiviteti 4.1: Hartimi i analizës së nevojave dhe efektivitetit të shërbimeve/MATP për këto dy komunitete

Gjatë vitit 2018 ishin identifikuar disa raporte që pjesërisht e adresojnë këtë aktivitet, më saktësisht çështjen e identifikimit të nevojave dhe sfidave specifike të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian sa i përket punësimit dhe promovimit të punësimit, si dhe perceptimeve të tyre për qasjen në shërbime/masa të promovimit të punësimit dhe efektivitetin e tyre[16].Gjatë vitit 2019 ka pasur përparime të mëtejme në këtë aspekt me publikimin e raportit nga KOSINT 2020 i cili trajton nivelin dhe sfidat në lidhje me përfitimin e e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nga shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës të ofurara nga APRK, me përqëndrim nëkatër komuna me përfaqësim më të lartë të këtyre komuniteteve (Gjakova, Prizreni, Fushë Kosova dhe Obiliqi)[17]. Mirëpo, të dhënat e prezantuara në këtë raport në lidhje me rezultatet e masave janë të kufizuara në të dhënat që i mbledhin Zyrat e Punësimit për këtë çështje, që nuk bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe sistematike. Në raport prezantohen këto të dhëna vetëm për numrin e përfituesve të punësuar pas përfitimit nga masat e praktikës në punëpër Zyrën e Punësimit të Fushë Kosovës (1 i punësuar, përderisa ishin 15 përfitues).

[16]A. Rizvanolli për Projektin KOSINT, Analizë Teknike dhe Rekomandimet për Politika për. Promovimin e Punësimit të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2018
G. Shehu për Projektin KOSINT Monitorimi i Strategjisë Sektoriale të MPMS në lidhje me nivelin e punësimit të pjesëtarëve tëkomuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2018
Nevo Koncepti, Analizë e gjendjes aktuale të punëtorëve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Prizrenit, 2018
[17] V. Mujku për Projektin KOSINT, Monitorimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në lidhje meefektivitetin e Masat Aktive të Tregut të Punës (MATP-ve) për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Mirëpo, raportet ekzistuese shtojnë pak vlerë në kuptim të matjes në mënyrë sistematiketë efektivitetit të shërbimeve dhe masave përmes një metodologjie rigoroze dhe matësve sasiorë

> Në vitin 2019 ka pasur një hulumtim të realizuar nga Projekti KOSINT i cili ka kontribuar në realizimin e pjesërishëm të këtij aktiviteti. Raporti trajton përfitimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK dhe i identifikon sfidat në këtë aspekt. Megjithatë, studim sasior i efektivitetit të masave dhe shërbimeve në arritjen e rezultateve të punësimit tek pjesëmarrësit e këtyre komuniteteve sic e parashen Strategjia, nuk është realizuar. Gjithashtu, efekti i saj nuk materializohet përderisa gjetjet nuk përdoren për dizajnimin/modifikimin dhe ofrimin e masave në bazë të tij.

objektivë siç janë statusi i punësimit i përfituesve pas përfimit të shërbimit/masës, qëndrueshmëria e punësimit, efekti në të ardhura, cilësia e vendit të punës, etj.APRK në bashkëpunim me Organizatën Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ) për herë të parëgjatë vitit 2019 ka publikuar hulumtim sasior gjithëpërfshirës për efektin e masave aktive të tregut të punës (përfshirë trajnimin profesional) që i APRK i ofron për të gjithë përfituesit. Në kuadër të kësaj analize është tentuar qëindikatorët relevantëtë llogariten edhe në nivel të komuniteteve të ndryshme, mirëpo për shkak të numrit të vogël të vrojtimeve për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, kjo ka qenë e pamundur.

3.5 Masa 5: Dizajnimi/ modifikimi i shërbimeve të punësimit dhe masave aktive të punës në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali

Masa 5 parasheh që në bazë tëgjetjevetë vlerësimit të nevojave dhe efektivitetit të shërbimeve dhe masat aktive të tregut të punës të realizuar më herët, të dizajnohen/modifikohen shërbimet dhe masat aktivepër këto komunitete dhe ato të ofrohen në baza vjetore në vitet 2018 dhe 2019. Kjo do të përfshinte, në rast nevoje, ofrimin e shërbimeve shtesë (p.sh. kurse të gjuhës ose mbulimi i kostos së transportit) në mënyrë që të sigurohet përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali. Kjo do të bëhej me pjesëmarrjen aktive të OJQ-ve të komuniteteve rom dhe ashkali, dhe masat do të ishin të llojllojshme, duke përfshirë, në mes tjerash, trajnimin dhe punën praktike (të subvencionuara) në sektorin privat; subvencionimin e pagës për një kohë të caktuar; masa për zhvillimin e vetë-punësimit, përfshirë edhe grantet për fillimin e biznesit.

Realizimi i kësaj mase do tëmund të kishte efekt domethënës në punësimin e këtyre komuniteteve, duke qenë se do të siguronte qasje më të mirë të tyre në shërbime dhe masa aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK dhe përmirësim të cilësisë dhe përshtatshmërisë se shërbimeve dhe masave me kërkesat e punëkërkuesve.

3.5.1 Aktiviteti 5.1: Dizajnimi i MATP-ve/shërbimeve të punësimit në bazë të hulumtimit

Duke qenë se dizajnimi i shërbimeve ose MATP-ve të reja parashihej të bëhej në bazë të rezultateve të analizës në Aktivitetin 4.1, nënkuptohet që ky aktivitet nuk ka mundur të realizohet sic ka qenë i paraparë. Megjithatë, APRK gjatë vitit 2019 ka ofruar dhe bashkëfinancuar në bashkëpunim me OJQ VoRAE njëskemëtë praktikës në punë që ka targetuar specifikisht të papunët e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, gjë që duhet të ketë mundësuar informim dhe qasje më të mirë të këtyre komuniteteve.

Duke qenë se ky aktivitet bazohet në Aktivitetin 4.1, i cili nuk është realizuar (plotësisht), nënkuptohet që ky aktivitet nuk ka mundur të realizohet sic ka qenë i paraparë.Megjithatë, APRK në bashkëpunim me OJQ VoRAE ka ofruar një skemë që ka targetuar specifikisht këto komunitete.Efekti i kësaj nuk mund të vlerësohet në mungesë të të dhënave.

3.5.2 Aktiviteti 5.2: Ofrimi i MATP-ve dhe granteve për fillim të biznesit

Bazuar në Aktivitetet 4.1 dhe 5.1, Aktiviteti 5.2 parasheh ofrimin e MATP-ve për 300 përfitues dhe tëgranteve për fillim biznesi për 10 përfitues të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian. Sikurse gjatë vitit 2018, megjithëse shërbime ose masa të reja nuk janë dizajnuar specifikisht për pjesëtarët e këtyre komuniteteve, APRK edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar tëofrojë masa aktive të tregut të punës për këto komunitete. Sipas të dhënave të ofruara nga APRK, gjatë vitit 2019 nga masat aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK kanë përfituar gjithsej 200 pjesëtarë të këtyre komuniteteve,përderisa Strategjia parasheh 300 përfitues (shih Tabelën 3.2). Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe u ndanë13grante për fillim të biznesitpër pjesëtarë të këtyre komuniteteve, që e tejkalon cakun prej 10 përfituesve.

Tabela 3.2: Përfituesit e masave aktive të tregut të punës nga APRK

Masa aktive e tregut të punës	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total
Aftësim profesional në QAP	21	40	33	**94**
Vetëpunësim	5	5	3	**13**
Trajnim në punë	4	13	4	**21**
Praktikë profesionale	6	16	3	**25**
Subvencionim i pagës	9	13	12	**34**
Punë publike	5	6	2	**13**
Total	**50**	**93**	**57**	**200**

Burimi: APRK

Numri i përfituesve të granteve për fillim biznesi në vitin e fundit ka rënë dukshëm prej 40 sa ishte në vitin 2018 kur kishte një fokus të theksuar tëinstitucioneve dhe donatorëve në përkrahjen e të riatdhesuarve nga vendet e Evropës përmes granteve të vetëpunësimit, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve i përkisnin këtyre tri komuniteteve.Sa i përket përfituesve të MATP-ve në përgjithësi (përfshirë trajnimin profesional në QAP), gjithashtu ka rënie nga viti paraprak kur ishin 223 përfitues.

Duke qenë se ky aktivitet bazohet në Aktivitetin 4.1, i cili nuk është realizuar në mënyrë të plotë dhe të paraparë me Strategji, nënkuptohet që ky aktivitet nuk ka mundur të realizohet sic ka qenë i paraparë.

3.6 Masa 6: Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës

Masa 6 parasheh organizim të fushatave informuese të dizajnuara në mënyrë të tillë që të sigurohet qasja tek komunitetet rom dhe ashkali, duke pasur parasysh mediat dhe mënyrat e komunikimit që shfrytëzohen nga këto komunitete; fushtatat do të përfshinin edhe vizita të këshilltarëve të punësimit në terren. Fushatat do të shfrytëzonin kapacitetet ekzistuese dhe qasjen te komunitetet të qendrave për mësimnxënie dhe OJQ-ve të këtyre komuniteteve.

Realizimi i kësaj mase nuk do të kishte efekt direkt dhe të menjëhershëm, por do të mund të përmirësonte rezulatet në tregun e punës duke siguruar informim dhe vetëdijësim për shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës që i ofron APRK, duke siguruar qasje më të mirë të këtyre komuniteteve tek këto shërbime dhe masa.

3.6.1 Aktiviteti 6.1: Organizimi i fushatës së informimit me pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali

Sikurse gjatë vitin 2018, edhe gjatë vitit 2019 janë identifikuar raste të aktiviteteve informimit dhe raste bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile në disa komuna. P.sh., sipas intervistave me Zyrat e Punësimit të këtyre komunave, në Pejë ka pasurtakim me pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian për mundësitë e puënsimit/trajnimit, bashkëpunim me OJQ Syri i Vizionit, dhe panaire të punës në bashkëpunim me OSBE-në në Pejë dhe Istog, ku kanë qenë të ftuar pjesëtarët e këtyre komuniteteve; në Mitrovicë ka pasur disa fushata informimi në nivel lokal dhe dhe sesione informuese të organizuara në bashkëpunim me Këshillin Danez për Refugjatë (DRC); në Ferizaj ka pasur bashkëpunim me VoRAE; në Prizren ka pasur paraqitje të zyrtarëve për të raportuar në Radio Romano Avazo; dhe në Suharekëdiskutime me pjesëmarrës të OJQ-ve[18]. Mirëpo, në nivel të APRK-së, qëështë organizaë e re e cila është përballur me sfida të tranzicionit institucional, nuk ka pasur fushata informimi, në përgjithësi apo për grupe të caktuara punëkërkuesish.

[18]Intervista ishin planifikuar edhe me Zyrat e Punësimit të Gjakovës dhe Fushë Kosovës, por nuk ka pasur përgjigje pozitive nga përfaqësuesit e këtyre zyrave.

Megjithatë, sipas rezultateve të anketës së realizuar me 139 persona në pesë komuna (Ferizaj, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Pejë dhe Gjakovë) në fund të vitit 2019, 74% të të anketuarve ishin të informuar për Zyrat e Punësimit. Kjo sugjeron që ka një përmirësim në krahasim me rezultatet e anketës së realizuar në pranverë të vitit 2018, megjithëse tëdy anketat nuk mund të konsiderohen reprezentative për popullacionin prandaj rezultatet duhet të konsiderohen vetëm indikative.

Sikurse gjatë vitit paraprak, edhe në vitin 2019 ka pasur raste të aktiviteteve informuese (në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile) në disa komuna, mirëpo nuk ka pasur fushata apo aktivitete promovuese sistematike nga ana e APRK-së.

3.7 Masa 7: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali

Masa 7 parasheh promovimin e rasteve e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali që kanë arritur sukses në punësim ose vetëpunësim/biznes, me fokus të veçantë tek gratë.

Realizimi i kësaj mase nuk do të kishte efekt direkt dhe të menjëhershëm, por do të mund të përmirësonte rezulatet në tregun e punës duke siguruar informim dhe vetëdijësim për mundësitë që ofrohen sa i përket arsimimit, trajnimit, masave aktive të tregut të punës, punësimit, të bërit biznes, etj.

3.7.1 Aktiviteti 7.1: Emetimi i videove promovuese

Si pjesë e promovimit të rasteve të suksesit, Aktiviteti 7.1 parasheh zhvillimin dhe emetimin e videove me persona të këtyre komuniteteve që kanë arritur sukses në tregun e punës (qoftë në punësim ose vetëpunësim). Gjatë hulumtimit nuk janë identifikuar aktivitete të tilla.

Sikurse gjatë viteve të kaluara, nuk është shënuar përparim në zbatimin e këtij aktiviteti.

3.7.2 Aktiviteti 7.2: Takime me qytetarët

Gjithashtu në kuadër promovimit të rasteve të suksesit, Aktiviteti 7.1 parasheh takime të përbashkëta të institucioneve dhe personave të këtyre komuniteteve që kanë arritur sukses në tregun e punës (qoftë në punësim ose vetëpunësim) me qytetarë të këtyre komuniteteve. Gjatë hulumtimit nuk janë identifikuar aktivitete të kësaj natyre.

Sikurse gjatë viteve të kaluara, nuk është shënuar përparim në zbatimin e këtij aktiviteti.

5. Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit

Përmes masave dhe aktiviteve të diskutuara në Seksionin paraprak, Strategjia synon arritjen e rezultateve në nivel të objektivit të përmirësimit të situatës ekonomike të komuniteteve rom dhe ashkali në tri fusha: përmirësimin e gjendjes së punësimit dhe përfshirjen në MATP dhe zbutjen e dallimeve gjinore në këto aspekte, dhe përfshirjen në puësim në sektorin publik të këtyre komuniteteve. Nënseksionet në vijim diskutojnë indikatorët për matjen e arritjes së objektivit, caqet e vendosura për vitet 2019 dhe 2021 si dhenivelin e realizimit të tyre në vitin 2019.

4.1 Indikatori 1: Norma e punësimit

Në vitin bazë (2016) të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 Indikatori 1 në nivel të objektivit, norma e punësimit të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian[19], nuk ka qenë e mundur të llogaritet për shkak të mungesës së të dhënave. Megjithatë, Strategjia ka paraparë që ky indikator të llogaritet për herë të parë nëvitin 2017 (në kuadër të Aktivitetit 1.1) dhe në vitet 2019 dhe 2021 të ketë tendencë të rritjes së normës së punësimit në krahasim me vitin 2017 (shih Tabelën 4.1). Ky indikator është ngjashëm me zotimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e normës së punësimit në së paku 25% në kuadër të Deklaratës së Ballkanit Perëndimor mbi integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së të nënshkruar nëPoznan të Polonisë në Korrik të vitit 2019.

Tabela 4.1: Indikatori 1: Norma e punësimit

Treguesi	Baza	Caqet	
	2016	2019	2021
Norma e punësimit	Mungojnë të dhënat	Tendenca në rritje	Tendenca në rritje

Burimi: Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021

[19]Norma e punësimit nënkupton raportin në mes numrit të personave të punësuar (përfshirë ata të vetëpunësuar) dhe numrit të përgjithshëm të personave në moshë pune.

Meqë statistikat e tregut të punës nga të dhënat zyrtare ose nga burime/studime të tjera nuk janë llogaritur, është e pamundur të vlerësohet nëse caku për vitin 2019 është arritur.

Në mungesë të të dhënave, është e pamundur të vlerësohet nëse është arritur caku për vitin 2019, ngritja e normës së punësimit në krahasim me vitin 2017.

4.2 Indikatori 2: Norma e punësimit të grave

Vlera bazë (për vitin 2017) për Indikatorin 2 në nivel të objektivit, normën e punësimit të grave, është përllogaritur në bazë të një studimi mbi punësimin e grave të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, meqë nuk ka pasur të dhëna zyrtare. Strategjia ka paraparë që norma e punësimit të grave të këtyre komuniteteve prej 9% në vitin 2017 të rritet nga 3 pikë të përqindjes përgjatë periudhave 2016-2019 dhe 2019-2021.

Tabela 4.2: Indikatori 2: Norma e punësimit të grave

Treguesi	Baza	Caqet	
	2016	2019	2021
Norma e punësimit të grave	9%	12%	15%

Burimi: Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021

Sikurse për normën e punësimit për këto komunitete në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe nuk janë llogaritur statistikat e tregut të punës për gratë, qoftë nga të dhënat zyrtare ose nga burime/studime të tjera. Rrjedhimisht, është e pamundur të vlerësohet nëse caku për vitin 2019 është arritur.

Në mungesë të të dhënave, është e pamundur të vlerësohet nëse është arritur caku për vitin 2019.

4.3 Indikatori 3: Përfshirja në MATP

Indikatori 3 i referohet përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në masat aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK (përfshirë aftësimin profesional), të matur me pjesëmarrjen e përfituesve të këtyre komuniteteve në numrin e përgjithshëm të përfituesve të këtyre masave.Strategjia parasheh rritje të vazhdueshme të pjesëmarrjes së këtyre komuniteteve në MATP, duke arritur 13% në vitin 2021 (shih Tabelën 4.3).

Tabela 4.3: Indikatori 3: Përfshirja në MATP

Treguesi	Baza	Caqet	
	2016	2019	2021
Përfshirja në MATP	6%	10%	13%

Burimi: Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021

Gjatë vitit 2019 përqindja e përfituesve të këtyre komuniteteve ishte 1.5%, përderisa caku për këtë vit ishte 10%. Për më tepër, gjatë viteve të Strategjisë ka pasur trend negativ (Figura 4.1).

Figura 4.1: Përfshirja në MATP (2016-2019)



Gjatë vitit 2019 caku i pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali e egjiptian prej 10% nuk është arritur.

Burimi: APRK

4.4 Indikatori 4: Përfshirja e grave në MATP

Indikatori 4 matë përfshirjen e grave të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në MATP si përqindje të grave në kuadër të numrit të përgjithshëm të përfituesve të MATP-ve nga këto komunitete. Në vitin 2016 vetëm 12% të përfituesve të MATP-ve nga këto komunitete ishin gra, ndërsa caku për vitin 2019 ishte 25%.

Tabela 4.4: Indikatori 4: Përfshirja e grave në MATP

Treguesi	Baza	Caqet	
	2016	2019	2021
Përfshirja e grave në MATP	12%	25%	

Burimi: Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021

Gjatë vitit 2019, 40% e përfituesve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian ishin gra, përderisa caku për këtë vit ishte 25%. Megjithatë, duhet pasur parasysh që numri total i pjesëmarrësve në MATP nga këto komunitete ka pasur trend negativ.

Gjatë vitit 2019 caku i pjesëmarrjes së grave në numrin e përgjithshëm të përfituesve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian prej 25% është tejkaluar, duke arritur40%.

4.5 Indikatori 5: Përfshirja në punësim në sektorin publik

Indikatori 5 matë përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në punësim në sektorin publik, në qeverisjen qendrore, lokale dhe ndërmarrjet publike. Strategjia parasheh dyfishim të pjesëmarrjes së këtyre komuniteteve në punësim në sektor publik, duke arritur në 1% në vitin 2019 (Tabela 4.5). Ky indikator është i ngjashëm me zotimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen rritjen e punësimit në sektor publik proporcionalisht me pjesëmarrjen në popullatën në tërësi në kuadër të Deklaratës së Ballkanit Perëndimor mbi integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së

Tabela 4.5: Indikatori 5: Përfshirja në punësim në sektorin publik

Treguesi	Baza	Caqet	
	2016	2019	2021
Përfshirja në punësim në sektorin publik	0.5%	1%	

Burimi: Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021

Sipas raportit të publikuar nga Projekti KOSINT[20], gjatë vitit 2017, nga 56 institucione të nivelit qendror 12 prej tyre punësonin 104 pjëstarë të komuniteteve rom, ashkali ose egjiptian (shih Tabelën 3.1).

Tabela 3.1: Punësimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në institucionet e nivelit qendror (2017)

Nr.	Institucioni	Numri i përgjithshëm i të punësuarve	Rom	Ashkali	Egjiptian
1.	Ministria e Shëndetësisë	7,695	15	3	11
2.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	775	0	0	1
3.	Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal	260	0	0	1
4.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1,032	3	0	0
5.	Ministria e Financave	1,031	1	0	0

[20] Dh. Prokshi për Projektin KOSINT, Respektimi i kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet publike, 2019

6.	Ministria e Drejtësisë	1,850	9	1	0
7	Ministria e Punëve të Brendshme	1,894	3	0	1
8.	Shërbimi Policor i Kosovës	8,743	16	19	8
9.	Avokati i Popullit	48		1	0
10.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1,574	7	2	0
11.	Ndihmë Juridike Falas	26		0	1
12.	Agjencioni Kosovar i Pronës	198	1	0	0

Burimi: KOSINT (2019)

Ndërsa, gjatë vitit 2018, nga 30,635 të punësuar në institucione të nivelit qendror, 111 (ose 0.36%) ishin pjestarë të komuniteteve rom, ashkali ose egjiptian (shih Tabelën 3.2).

Tabela 3.2: Punësimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në institucionet e nivelit qendror (2018)

Nr.	Institucioni	Numri i përgjithshëm i të punësuarve	Rom	Ashkali	Egjiptian
1.	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	525	0	0	1
2.	Ministria e Shëndetësisë	7,723	19	3	12
3.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	771	1	0	0
4.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1,496	3	0	1
5.	Ministria e Financave	1,064	1	0	0
6.	Ministria e Drejtësisë	1,862	9	1	0
7	Ministria e Punëve të Brendshme	1,894	3	0	1
8.	Shërbimi Policor i Kosovës	8,680	16	19	8
9.	Shërbimi Doganor	583	3	2	3
10.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1,097	2	1	2

Burimi: KOSINT (2019)

Sipas raportit të publikuar nga KOSINT 2020 në vitin 2019, në institucionet publike në nivel lokal (që përfshijnë administratën lokale, institucione arsimore dhe shëndetësore) përfaqësimi mbetet përgjishësisht i pakënaqshëm nëse krahasohet pjesëmarrja e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian me pjesëmarrjen e tyre në popullatën e përgjithshme të komunave me pjesëmarrje më të lartë të këtyre komuniteteve.

Në Fushë Kosovë ka pasur rënie të numrit të të punësuarve nga rradhët e këtyre komuniteteve nga 8 në vitin 2016 në 5 në dy vitet vijuese (shih Tabelën 3.3), përkatësisht nga 1.15% të puënsimit total në 0.73%. Kjo përqindje është shumë e vogël në krahasim me pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në popullatën e Fushë Kosovës, qëështë 11.34%[21].

[21]Po aty.

Tabela 3.3: Punësimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nëinstitucione lokale: Fushë Kosovë

Viti	Administratë				Arsim				Shëndetësi			
	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian
2016	145	2	3	0	447	2	0	0	104	0	1	0
2017	115	1	0	1	468	2	0	0	105	0	0	1
2018	116	0	1	1	468	2	0	0	105	0	0	1

Burimi: KOSINT (2019)

Në Ferizaj gjithashtu ka pasur rënie të numrit të të punësuarve nga rradhët e këtyre komuniteteve nga 20 në vitin 2016 në 15 në dy vitet vijuese(shih Tabelën 3.4), përkatësisht nga 0.84% të puënsimit total në 0.64%. Sikurse edhe në Fushë Kosovë, këto shifra janë të ulëta në krahasim me pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në popullatën e përgjithshme të komunës që është 5.8%[22].

Tabela 3.4: Punësimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nëinstitucione lokale: Ferizaj

Viti	Administratë				Arsim				Shëndetësi			
	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian
2016	249	3	9	0	1817	1	5	0	308	2	0	0
2017	301	1	6	0	1730	0	5	1	308	1	0	1
2018	300	0	6	1	1747	0	5	1	308	2	0	0

Burimi: KOSITN 2020 (2019)

Nga ana tjetër, në Gjakovë ka pasur rritje të dukshme të numrit të të punësuarve nga këto komunitete: nga 5 në vitin 2016, 31 në vitet 2017 dhe 2018 (shih Tabelën 3.5), përkatësisht nga 0.29% në 1.5% dhe 1.92%. Megjithatë kjo pjesëmarrje është relativisht e ulët duke marrë parasysh pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në popullatën e përgjithshme të komunës që sipas regjistrimit të fundit të popullsisëështë 6.84%[23].

[22]Po aty.
[23]Po aty.

Tabela 3.5: Punësimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nëinstitucione lokale: Gjakovë

Viti	Administratë				Arsim				Shëndetësi			
	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian
2016	223	0	0	5	1216	0	0	0	280	0	0	0
2017	213	0	0	5	1501	7	8	11	347	0	0	0
2018	213	0	0	5	1051	7	8	11	347	0	0	0

Burimi: KOSINT 2020 (2019)

Në Mitrovicë numri i të punësuarve të këtyre komuniteteve ishte shumë i vogël në vitin 2016 (vetëm 2 persona), por që nga viti 2017 nuk ka asnjë të punësuar nga rradhët e këtyre komuniteteve (shih Tabelën 3.6), përderisa pjesëmarrja e këtyre komuniteteve në popullatën e përgjithshme të komunës është 2.5%[24].

Tabela 3.6: Punësimi i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nëinstitucione lokale: Mitrovicë

Viti	Administratë				Arsim				Shëndetësi			
	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian
2016	366	1	1	0	1216	0	0	0	280	0	0	0
2017	349	0	0	0	1216	0	0	0	256	0	0	0
2018	298	0	0	0	1225	0	0	0	271	0	0	0

Burimi: KOSINT 2020 (2019)

[24]Po aty.

Raporti nuk e paraqet gjendjen e punësimit të këtyre komuniteteve në ndërmarrje publike, dhe as përfshirjen e këtyre komuniteteve në numrin e gjithëmbarshëm të të punësuarve në nivel vendi.

> Në bazë të të dhënave jo të plota, gjatë vitit 2018 pjesëmarrjes e romëve, ashkalive e egjiptianëve në punësim në sektorin publik ishte 0.4%. Përkundër mangësive në të dhëna, është e arsyeshme të konkludohet se caku prej 1% në vitin 2019 nuk do të arrihet.

Prandaj, në mungesë tëkëtyre informatave, norma e punësimit është përllogaritur nën këto kushte: (i) për numrin total të të punësuarve në komuna janë shfrytëzuar parashikimet për numrin e stafit nëpër komuna nga Buxheti i vitit 2019[25], dhe (ii) nuk janë marrë parasysh. Në këto kushte, në bazë të përllogaritjeve bazuar në të dhënat e hulumtimit nga Projekti KOSINT të fokusuar në sektorin publik në nivel qendror dhe në nivel komunal në komunat Fushë Kosovë, Ferizaj, Gjakovë dhe Mitrovicë, pjesëmarrja e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në numrin e përgjithshëm të tëpuënsuarve në vitin ishte 0.4%.

[25] Ligji LIGJI NR. 06/L -133 mbi Ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019

6. Konkludimet dhe rekomandimet

Ky raport ka vlerësuar nivelin e zbatimit të masave, aktiviteteve, dhe rezultateve (ku kanë lejuar të dhënat) të dedikuara për përmirësimin e punësimit të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në bazëtë Strategjsë Sektoriale të MPMS 2018 – 2022, e cila për këtëçështje i referohet Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021.

Hulumtimi është bazuar në: (i) hulumtim dhe rishikim të dokumenteve strategjike, analizave, të dhënave dhe dokumenteve të tjera relevante në këtëfushë(me fokus të vecantë në ato të publikuara gjatë vitit 2019), (ii) intervistave gjysmë të strukturuara (individuale e grupore) me institucionet relevante dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me çështjet e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, dhe (iii) anketës me pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian.

Gjatëtri viteve të zbatimit të kësaj Strategjie (2017-2019) janë zbatuar disa aktivitete të kësaj Strategjie:

- ✓ Që nga viti 2017, në raportin vjetor të APRK-së Puna dhe Punësimi ka filluar raportimi i statistikave nga SIMP për këto të tri komunitete veç e veç, gjë që mundëson monitorimin e gjendjes për tregues si numri dhe përqindja e punëkërkuesve të regjistruar, punëkërkuesve për të cilët është ndërmjetësuar punësimi, pjesëmarrësve në trajnime profesionale dhe masa tjera aktive të tregut të punës, etj. Megjithëse kjo nuk ka ndikim direkt në punësim, përfaqëson përparim domethënës sepse tani mund të monitorohet mbështetja institucionale për promovimin e punësimit të këtyre komunitetve të ofruar nga APRK si institucion i mandatuar përë këtë cështje, dhe rrjedhimisht vetëdijësim dhe avokim më të fuqishëm.

- ✓ Gjatë viteve 2018 dhe 2019 ka pasur disa hulumtime të organizatave të ndryshme (p.sh. KOSINT, ILO, Nevo Koncept) të cilat kanë hulumtuar sfidat, nevojat dhe perspektivën e punësimit dhe sfidat e përfshirjes së pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në masat aktive të tregut të punës.Këto mund të ndihmojnë për të dizajnuar shërbime dhe masa për promovimin e punësimit që janë në përputhje me nevojat specifike të këtyre komuniteteve.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur përparim në disa aktivitete të tjera, megjithëse ato nuk janë zbatuar plotësisht ose nuk janë zbatuar në mënyrën e paraparë në Strategji:

- ✓ Nga shoqëria civile, më saktësisht përmes një hulumtimi të përkrahur nga Projekti KOSINT, është monitoruar dhe raportuar situata e përfaqësimit të këtyre komuniteteve në punësim

në sektorin publik në nivel të institucioneve qendrore dhe institucioneve lokale në disa komuna. Mirëpo nuk janë përfshirë të gjitha komunat dhe ndërmarrjet publike, gjë që pamundëson vlerësimin e kuotës së përgjithshme për pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në tërë sektorin publik. Në bazë të këtij hulumtimi ka pasur disa aktivitete informimi dhe avokimi, dhe është mundësuar që gjatë viteve në vijim të intensifikohet puna në vetëdijësimin e qytetarëve dhe të institucioneve në këtë aspekt, si dhe avokimi dhe presioni publik tek insitucionet për të përmirësuar gjendjen.

→ Megjithëse nuk janë zbatuar kuota për pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në masat aktive të tregut të punës, nëdokumentin kryesor politikëbërës në fushën e provomimit të punësimit nga MPMS, Politikën e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021, janë vënë caqe vjetore për përshirjen e komuniteteve rom, ashkali e egjiptiannë masat aktive të tregut të punës të ofuara nga APRK.Mirëpo, këto caqejanë caktuarmë të ulta sesa ato të parapara nëStrategji dhe as këto nuk janë arritur.Rekomandohet që arsyet e mosarritjes sëcaqevetë analizohen bashkërisht nga APRK dhe MPMS për t'a evituar këtë në të ardhmen.Varëisht nga kjo, mund të konsiderohet rritja e këtyre caqevegjatë rishikimit të dokumentit tëPolitikëssë Punësimit që do të ndodhë së shpejti.

→ Megjithëse nuk janë dizajnuar shërbime ose masa specifikie që janë në përputhje me nevojat e këtyre komuniteteve specifikisht, ka pasur zbatim të pjesshëm. Gjatë vitit 2018 këto komunitete kanë marrë pjesë në masa aktive të tregut të punës të rregullta të ofruara nga APRK (223 pjesëmarrës të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, në krahasim me 300 pjesëmarrës sa ishin paraparë). Gjatë vitit 2019 ka pasur përparim në kuptim të ofrimit të MATP-ve të dedikuara për këto komunitete, në bashkëpunim me OJQ VoRAE, gjë që ka arritur të përmirësojë qasjen e këtyre komuniteteve. Mirëpo, megjithatë, gjatë këtij viti kanë përfituar vetëm 200 përfitues nga rradhët e këtyre komuniteteve (në krahasim me 300 sa ishin paraparë me Strategji). Nga ana tjetër, norma e granteve për fillim biznesiprej 10 përfituesve është tejkaluar, duke arritur 13 përfitues të këtyre komuniteteve në vitin 2019.Sicështë cekur më lart, rekomandohet që arsyet e mosarritjes së caqeve të pjesëmarrjes në MATP të analizohen bashkërisht nga APRK dhe MPMS dhe të merren masat e duhura për të përmirësuar gjendjen përgjatë viteve në vijim.

→ Megjithëse nga organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2018 dhe 2019 janë organizuar disa aktivitetete me qëllim të informimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e

egjiptian në disa komuna.Mirëpo, nuk ka pasur fushatë informimi të organizuar nga APRK për punëkërkuesit në përgjithësi, e as për këto komunitete specifikisht.Rekomandohet që fushata e APRK-së në vitet e ardhshme të përfshijë edhe aktivitete, kanale informimi dhe materiale promovimi të përshtatshme për të arritur qasje tek këto komunitete.

Nga ana tjetër, në disa aktivitete tjera nuk është arritur fare përparim:

- Nuk janë bërë përpjekje për të përllogaritur statistikat standarde të tregut të punës në bazë të AFP-së ose burimeve të tjera të të dhënave. Rekomandohet që ZQM dhe MPMS të ndërmarrin hapa për të inicuar këtë aktivitet me Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

- Nuk janë analizuar efektet e shërbimeve dhe masave aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK nëaspekt të rezultateve të matshme dhe objektive sa i përket përmirësimit të punësimit, nivelit të pagave, etj., që do të ishte e rëndësishme për dizajnimin/modifikimin e shërbimeve dhe masave në të ardhmen. Rekomandohet që tani që APRK ka përvojë me disa hulumtime të ngjashme, këto analiza të bëhen edhe specifikisht për anëtarët e këtyre komuniteteve.

- Nuk janë angazhuar këshilltarë punësimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, dhe një aktivitet i tillëështë cilësuar i pamundshëmbrenda kornizës ligjore në fuqi. Prandaj, rekomandohet qëky aktivitet të rishikohet nga ana e ZQM me ndihmën e ekspertëve juridikë dhe APRK-së që të vlerësohet nëse ky aktivitetet duhet të revidohet ose të hiqet fare nga Strategjia.

- Nuk janë promovuar në mënyrë sistematike dhe të udhëhequr nga institucionet rastet e suksesit në treg të punës të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve.Rekomandohet që kjo të bëhet në kuadër të fushatës gjithëpërfshirëse informuese të APRK-së në vitet në vijim, duke siguruar përfshirje të shoqërisë civile dhe kanaleve të informimit që mundësojnë qasjen e suksesshme tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian.

Tabelat 5.1 dhe 5.2 në vijim paraqesin një përmbledhje të arritjeve në drejtim të realizimit të masave dhe të treguesve të objektivit përkatës të Strategjisë gjatë viteve 2017 – 2019 dhe vlerësimin e arritjeve.

Tabela 5.1. Masat: Arritjet dhe vlerësimi i tyre

Masat	Arritjet 2017	Arritjet 2018	Arritjet 2019	Vlerësim i arritjeve
Masa 1: Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës	Janë raportuar treguesit nga APRK, por jo nga AFP ose burime të tjera.	Janë raportuar treguesit nga APRK, por jo nga AFP ose burime të tjera.	Janë raportuar treguesit nga APRK, por jo nga AFP ose burime të tjera.	⇨ Janë raportuar treguesit e APRK-së, që mundëson monitorimin e përkrahjes institucionale për punësimin e këtyre komuniteteve. Mirëpo, statistikat gjithëpërfshirëse të tregut të punës ende mungojnë.
Masa 2: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike	Nuk ka pasur monitorim dhe avokim. Nuk janë angazhuar këshilltarë të punësimit nga këto komunitete dhe nuk dihet nëse kjo është e mundshme si[është paraparë.	Nuk ka pasur monitorim dhe avokim. Nuk janë angazhuar këshilltarë të punësimit nga këto komunitete dhe nuk dihet nëse kjo është e mundshme si[është paraparë.	është raportuar gjendja në nivel qendror dhe në nivel lokal në 5 komuna dhe ka pasur disa aktivitete avokimi në bazë të kësaj. Nuk janë angazhuar këshilltarë të punësimit nga këto komunitete dhe nuk dihet nëse kjo është e mundshme si[është paraparë.	⇨ Ka informata për institucionet qeveritare në nivel qendror dhe për 5 komuna, por jo informata të plota ta në nivel vendi (që do të përfshinin të gjitha komunat dhe ndërmarrjet publike), dhe ka hapësirë për aktivitete të mëtejme avokimi në nivel qendror dhe lokal. Angazhimi i këshilltarëve të punësimit nga këto komunitete si[është paraparë duket i pamundshëm, dhe duhet të rishikohet.
Masa 3: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe	Nuk ka pasur hulumtim dhe zbatim të masave të aksionit afirmativ. Nuk janë zbatuar kuota për MATP.	Ka pasur një hulumtim që pjesërisht I trajton këto masa. Në Politikën e Punësimit për APRK 2019-2021 janë vendosur	Nuk ka pasur hulumtime të mëtejme. Në Politikën e Punësimit për APRK 2019-2021 ka vazhduar të ketë caqe për përfshirjen e	⇨ Hulumtimi i masave të aksionit afirmativ dhe zbatimi i rekomandimeve të tij si[janë paraparë, nuk janë realizuar. Në Politikën e Punësimit për APRK 2019-2021 janë vendosur caqe për

ashkali		caqe për përfshirjen e këtyre komuniteteve në MATP.	këtyre komuniteteve në MATP.	përfshirjen e këtyre komuniteteve në MATP, por këto janë më të ulta sesa ato të parapara në Strategji.
Masa 4: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP	Nuk ka pasur vlerësim të tillë.	Ka pasur disa hulumtime që pjesërisht e adresojnë vlerësimin e nevojave.	Ka pasur një hulumtim që pjesërisht e adreson efektivitetin dhe sfidat e ofrimit të shërbimeve dhe MATP-ve.	⇨ Megjithëse ka disa hulumtime që pjesërisht e adresojnë këtë masë, nuk ka vlerësim të nevojave specifike për MATP dhe efektivitetit të shërbimeve e masave në kuptim të rezultateve të punësimit që do të jepnin rekomandime specifike për dizajnimin e MATP-ve në përputhje me nevojat e këtyre komuniteteve.
Masa 5: Dizajnimi/ modifikimi i shërbimeve të punësimit dhe masave aktive të punës në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali Masa përfshin ofrimin e MATP-ve për 300 përfitues dhe granteve për fillim		Nuk ka pasur dizajnimi/ modifikim të shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve. Ka pasur 223 përfitues të MATP-ve dhe 40 përfitues të granteve të biznesit nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian.	Nuk ka pasur dizajnimi/ modifikim të shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve, por është ofruar një skemë e dedikuar për këto komunitete në bashkëpunim me shoqërinë civile. Ka pasur 200 përfitues të MATP-ve dhe 13 përfitues të granteve të	⇨ Nuk ka pasur dizajnimi/ modifikim të shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve, por MATP-të për këto komunitete janë ofruar në kuadër të aktiviteteve të rregullta të APRK-së (në vitin 2018) dhe, përve[kësaj, në kuadër të një skeme të dedikuar për këto komunitete në bashkëpunim me shoqërinë civile (në vitin 2019). As brenda këtyre aktiviteteve, nuk është

biznesi për 10 përfitues në vitet 2018 dhe 2019			biznesit nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian.	arritur caku prej 300 përfitues të MATP-ve në vit, megjithëse caku prej 10 përfitues të granteve për fillim biznesi është tejkaluar (pjesërisht për shkak të ndihmës së fokusuar tek të riathdhesuarit).
Masa 6: Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës	Nuk ka të dhëna.	Ka pasur disa iniciativa në nivel lokal në disa komuna, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.	Ka vazhduar të ketë iniciativa në nivel lokal në disa komuna, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.	⇨ Megjithëse ka pasur disa iniciativa në nivel lokal, nuk ka pasur fushata gjithëpërfshirëse dhe sistematike në kuadër të një strategjie për përmirësimin e qasjes së këtyre komuniteteve në shërbime dhe MATP të ofruara nga APRK.
Masa 7: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali	Nuk ka pasur promovim të tillë.	Nuk ka pasur promovim të tillë.	Nuk ka pasur promovim të tillë.	⇩ Nuk ka pasur promovim të rasteve të suksesit në tregun e punës përmes videove promovuese as takimeve me qytetarë.

Tabela 5.2.Treguesit për arritjen e objektivit: Arritjet dhe vlerësimi i tyre

Treguesit për arritjen e objektivit	Baza (2016)	Caku (2019)	Arritja (2019)	Vlerësimi i arritjes
Norma e punësimit (% e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në moshë pune që janë të punësuar)	Nuk ka të dhëna.	Trend pozitiv.	Nuk ka të dhëna.	Vlerësimi është i pamundur.
Norma e punësimit të grave (% e grave të këtyre komuniteteve në moshë pune që janë të punësuara)	9%	12%	Nuk ka të dhëna.	Vlerësimi është i pamundur.
Përfshirja në MATP (% e totalit të përfituesve të MATP-ve)	6%	10%	1.5%	Jo vetëm që caku prej 10% nuk është arritur, por ka pasur trend negativ.
Përfshirja e grave në MATP (% e totalit të përfituesve nga këto komunitete)	12%	25%	40%	Caku është tejkaluar, mirëpo kjo arritje zbehet duke pasur parasysh se pjesëmarrja e këtyre komuniteteve në përgjithësi nuk është e kënaqshme.
Përfshirja në punësim në sektorin publik	0.5%	1.0%	0.4% (vlerësim në bazë të të dhënave në dispozicion)	Megjithëse vlerësimi është në bazë të të dhënave jo të plota, mund të konkludohet që caku prej 1.0% nuk është arritur.

Si konkludim, mund të thuhet se i vetmi cak i arritur sa i përket treguesve për arritjen e objektivit të përmirësimit të gjendjes socioekonomike që kanë të bëjnë me punësimin është ai i përqindjes së grave në mesin e përfituesve të masave aktive të tregut të punës që vijnë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Mirëpo, rëndësia e kësaj arritjeje zbehet për faktin që në pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në këto masa (Treguesi 4) jo vetëm që nuk është arritur, por edhe ka treguar trend negativ. Përmirësimi i përfaqësimit të këtyre komuniteteve gjithashtu nuk është arritur, ndërsa sa i përket normës së punësimit (në përgjithësi dhe për gratë) në mungesë të të dhënave nuk mund të vlerësohet gjendja. Zbatimi i masave të parapara me Planin e Aktiviteteve për tri vitet e para të Strategjisë gjithashtu lë për të dëshiruar, me shumicën e aktiviteteve të zbatuara vetëm pjesërisht dhe kryesisht në kuadër të aktiviteteve të rregullta të institucioneve dhe/ose shoqërisë civile, dhe jo gjithmonënë përputhje me formën origjinale në të cilën janë paraparë në Strategji. Në bazë të kësaj, rekomandimi i përgjithshëm do të ishte që gjatë përpilim të Planit të Aktiviteteve për dy vitet e mbetura të Strategjisë të konsiderohet vazhdimi i zbatimit të aktiviteteve të mbetura të paëpërfunduara (përvec nëse ato konsiderohen të parealizueshme dhe që duhen rishikuar, si p.sh. në rastin e angazhimit të këshilltarëve të punësimit nga këto komunitete) dhe njëkohësisht të vazhdohen/avancohen aktivitetet aty ku ka hapësirë.

Masat	Arritjet 2017	Arritjet 2018	Arritjet 2019	Vlerësim i arritjeve
Masa 1: Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës	Janë raportuar treguesit nga APRK, por jo nga AFP ose burime të tjera.	Janë raportuar treguesit nga APRK, por jo nga AFP ose burime të tjera.	Janë raportuar treguesit nga APRK, por jo nga AFP ose burime të tjera.	Janë raportuar treguesit e APRK-së, gjëqë mundëson monitorimin e përkrahjes institucionale për punësimin e këtyre komuniteteve. Mirëpo, statistikat gjithëpërfshirëse të tregut të punës ende mungojnë.
Masa 2: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike	Nuk ka pasur monitorim dhe avokim. Nuk janë angazhuar këshilltarë të punësimit nga këto komunitete dhe nuk dihet nëse kjo është e mundshme siç është paraparë.	Nuk ka pasur monitorim dhe avokim. Nuk janë angazhuar këshilltarë të punësimit nga këto komunitete dhe nuk dihet nëse kjo është e mundshme siç është paraparë.	Është raportuar gjendja në nivel qendror dhe në nivel lokal në 5 komuna dhe ka pasur disa aktivitete avokimi në bazë të kësaj. Nuk janë angazhuar këshilltarë të punësimit nga këto komunitete dhe nuk dihet nëse kjo është e mundshme siç është paraparë.	Ka informata për institucionet qeveritare në nivel qendror dhe për 5 komuna, por jo informata të plota në nivel vendi (që do të përfshinin të gjitha komunat dhe ndërmarrjet publike), dhe ka hapësirë për aktivitete të mëtejme avokimi në nivel qendror dhe lokal. Angazhimi i këshilltarëve të punësimit nga këto komunitete siç është paraparë duket i pamundshëm, dhe duhet të rishikohet.
Masa 3: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali	Nuk ka pasur hulumtim dhe zbatim të masave të aksionit afirmativ. Nuk janë zbatuar kuota për MATP.	Ka pasur një hulumtim që pjesërisht i trajton këto masa. Në Politikën e Punësimit për APRK 2019-2021 janë vendosur caqe për përfshirjen e këtyre komuniteteve në MATP.	Nuk ka pasur hulumtime të mëtejme. Në Politikën e Punësimit për APRK 2019-2021 ka vazhduar të ketë caqe për përfshirjen e këtyre komuniteteve në MATP.	Hulumtimi i masave të aksionit afirmativ dhe zbatimi i rekomandimeve të tij siç janë paraparë, nuk janë realizuar. Në Politikën e Punësimit për APRK 2019-2021 janë vendosur caqe për përfshirjen e këtyre komuniteteve në MATP, por këto janë më të ulta sesa ato të parapara në Strategji.

Masa 4: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP	Nuk ka pasur vlerësim të tillë.	Ka pasur disa hulumtime që pjesërisht e adresojnë vlerësimin e nevojave.	Ka pasur një hulumtim që pjesërisht e adreson efektivitetin dhe sfidat e ofrimit të shërbimeve dhe MATP-ve.	Megjithëse ka disa hulumtime që pjesërisht e adresojnë këtë masë, nuk ka vlerësim të nevojave specifike për MATP dhe efektivitetit të shërbimeve e masave në kuptim të rezultateve të punësimit që do të jepnin rekomandime specifike për dizajnimin e MATP-ve në përputhje me nevojat e këtyre komuniteteve.
Masa 5: Dizajnimi/ modifikimi i shërbimeve të punësimit dhe masave aktive të punës në përputhje me nevojat e komuniteteve rom dhe ashkali Masa përfshin ofrimin e MATP-ve për 300 përfitues dhe granteve për fillim biznesi për 10 përfitues në vitet 2018 dhe 2019		Nuk ka pasur dizajnim/modifikim të shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve. Ka pasur 223 përfitues të MATP-ve dhe 40 përfitues të granteve të biznesit nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian.	Nuk ka pasur dizajnim/modifikim të shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve, por është ofruar një skemë e dedikuar për këto komunitete në bashkëpunim me shoqërinë civile. Ka pasur 200 përfitues të MATP-ve dhe 13 përfitues të granteve të biznesit nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian.	Nuk ka pasur dizajnim/modifikim të shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve, por MATP-të për këto komunitete janë ofruar në kuadër të aktiviteteve të rregullta të APRK-së (në vitin 2018) dhe, përveç kësaj, në kuadër të një skeme të dedikuar për këto komunitete në bashkëpunim me shoqërinë civile (në vitin 2019). As brenda këtyre aktiviteteve, nuk është arritur caku prej 300 përfituesve të MATP-ve në vit, megjithëse caku prej 10 përfitues të granteve për fillim biznesi është tejkaluar (pjesërisht për shkak të ndihmës së fokusuar tek të riathdhesuarit).
Masa 6: Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës	Nuk ka të dhëna.	Ka pasur disa iniciativa në nivel lokal në disa komuna, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.	Ka vazhduar të ketë iniciativa në nivel lokal në disa komuna, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.	Megjithëse ka pasur disa iniciativa në nivel lokal, nuk ka pasur fushata gjithëpërfshirëse dhe sistematike në kuadër të një strategjie për përmirësimin e qasjes së këtyre komuniteteve në shërbime dhe MATP të ofruara nga APRK.

Masa 7: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali	Nuk ka pasur promovim të tillë.	Nuk ka pasur promovim të tillë.	Nuk ka pasur promovim të tillë.	Nuk ka pasur promovim të rasteve të suksesit në tregun e punës përmes videove promovuese dhe as takimeve me qytetarë.

Masa 1: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike.

Aktiviteti 2.1: Monitorimi i situatës së punësimit në institucione publike në komunat me pjesëmarrje më të lartë të këtyre komuniteteve.

Ky aktivitet nuk është realizuar gjatë vitit 2018.

Aktiviteti 2.2: Monitorimi i situatës së punësimit në institucione publike në nivel qendror

Ky aktivitet, sic është paraparë në Strategji, nuk është realizuar gjatë vitit 2018, megjithëse ZQM në raportin e saj vjetor për zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021, për vitin 2017 e ka raportuar gjendjen e punësimit të këtyre komuniteteve në ministri dhe institucione të tjera në nivelin qendror.

Aktiviteti 2.3: Informimi dhe avokimi bazuar në rezultatet e hulumtimeve.

Ky aktivitet i pason aktivitetetet paraprake 2.1 dhe 2.2, prandaj nënkuptohet që nuk ka mundur të realizohet.

Aktiviteti 2.4: Punësimi i këshilltarëve të punësimit nga këto komunitete në komunat me numër më të madh të punëkërkuesve të këtyre komuniteteve

Ky aktivitet është realizuar gjatë vitit 2018 dhe janë ngritur dyshime nëse një formë e tillë e rekrutimit në baza etnike është fare e mundshme brenda kornizës ligjore në fuqi.

Aktiviteti 2.5: Trajnimi i këshilltarëve të punësimit të angazhuar

Kutia

Masa 3: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali

Aktiviteti 3.1: Hulumtim i masave të aksionit afirmativ që kanë funksionuar në vendet tjera

Gjatë vitit 2019 nukështë arritur përparim në këtë drejtim, megjithëse gjatë vitit 2018 kishte pasur një raport që ndër të tjera, ka analizuar praktikat ndërkombëtare për promovimin e punësimit të komunitetit rom në vendet tjera të Evropës nga Qendra Kosovare për Arsim (KOSINT), i cili kontribuon pjesërisht në realizimin e kësaj mase.

Aktiviteti 3.2: Zbatimi i kuotave në masa aktive të tregut të punës (përfshirë trajnime profesionale)

Megjithëse kuotat nuk janë zbatuar as gjatë vitit 2019, me anë të Politikëssë Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021, që është dokumenti kryesor politikëbërës në fushën e provomimit të punësimit nga MPMS, janënë fuqi caqet vjetore për përshirjen e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian. Megjithatë, këto caqe nuk janë në përputhje me Strategjinë, duke synuar përfshirje prej 6 për qind në vitin 2021, përderisa Strategjia parasheh përfshirje prej 10 për qind.Gjatë vitit 2018 pjesëmarrja ka qenë vetëm 2.6 për qind.Nuk ka pasur promovim të rasteve të suksesit në tregun e punës përmes videove

Kutia 3.2: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 3

Masa 4: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe i masave aktive të tregut të punës

Aktiviteti 4.1: Hartimi i analizës së nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve/masave aktive të tregut të punës për këto dy komunitete

Në vitin 2019 ka pasur një hulumtim të realizuar nga Projekti KOSINT i cili ka kontribuar në realizimin e pjesërishëm të këtij aktiviteti.Raporti trajton përfitimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga shërbimet e punësimit dhe nga masat aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK dhe i identifikon sfidat në këtë aspekt. Megjithatë, studimi sasiori efektivitetit të masave dhe i shërbimeve në arritjen e rezultateve të punësimit tek pjesëmarrësit e këtyre komuniteteve sic e parasheh Strategjia, nuk është realizuar.

Kutia 3.4: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 4
Kutia 3.5: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 5

Masa 5: Dizajnimi/modifikimi i shërbimeve (shtesë) të punësimit dhe i masave aktive të tregut të punës, përfshirë trajnimet profesionale, në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali

Aktiviteti 5.1: Gjatë vitit 2018 nuk janë dizajuar (ose modifikuar) masat aktive të tregut të punës/shërbimeve të punësimit specifikisht për të plotësuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian.

Aktiviteti 5.2: Ofrimi i:

a) masave aktive të tregut të punës (300 përfitues në vit); Granteve për fillim të biznesit (10 në vit)

Megjithëse nuk ka shërbime ose masa specifike për pjesëtarët e këtyre komuniteteve, APRK ka vazhduar të ofrojë masa aktive të tregut të punës për këto komunitete. Gjatë vitit 2018 nga masat aktive të punës kanë përfituar gjithësejt 223 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

b) Granteve për fillim të biznesit (10 në vit)

Gjatë vitit 2018 janë dhënë 40 grante për fillim të biznesit për pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Masa 7: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali

Aktiviteti 7.1: Emetimi i videove promovuese

Ky aktivitet nuk është realizuar gjatë vitit 2018.

Kutia 3.7: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 7



ROMA INTEGRATION 2020
Regional Cooperation Council